



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.236/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e shkalles se dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, çështjen përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli ne Prishtinë rr. “Nëna Terezë” nr.36, ndaj debitorit P.F.P “AGRO SERRA” me adresë rr. “Gjon Belushi” ne Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur sipas ankesës se kreditorit, e ushtruar kundër aktvendimit te Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.533/2023 dt.31.10.2023, me datë 19.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET si e themeltë ankesa e kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli ne Prishtinë rr. “Nëna Terezë” nr.36, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.533/2023 dt.31.10.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

II. REFUZOHET prapësimi i debitorit P.F.P “AGRO SERRA” me adresë rr. “Gjon Belushi” ne Mitrovicë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.1487/18 dt.31.10.2023, si i pa bazuar, MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor P.nr.1487/18 dt.31.10.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa, për territorin e Gjykatës Themelore Mitrovicë.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.533/2023 dt.31.10.2023, ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit P.F.P “AGRO SERRA” me adresë rr. “Gjon Belushi” ne Mitrovicë dhe urdhrin përmbarimor P.nr.1487/18 dt.31.10.2023, te lejuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa, për territorin e Gjykatës Themelore ne Mitrovicë, e ka shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit te gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës se dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë ne rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli ne Prishtinë rr. “Nëna Terezë” nr.36, me datën 19.12.2016, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit P.F.P “AGRO SERRA” me adresë rr. “Gjon Belushi” ne Mitrovicë, në bazë të dokumentit te besueshëm Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste me numër unik te Konsumatorit DMI106229, për periudhën prej 05.07.20211 deri me 20.03.2013. Përmbartuesi Privat Atip Mustafa nga Mitrovica, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim, me urdhrin përmbartimore P.nr.1487/18 dt.19.12.2018, ka lejuar përmbartimin dhe ka obliguar debitorin qe kreditorit ne emër te borxhit për konsum te energjisë elektrike, t’ia paguaj shumen prej 436.93 euro dhe atë ne afat prej 7 ditësh, me kamatë prej 8% nga dita e kalimit te afatit për pagesë e deri ne pagesën definitive.

Kundër urdhrin përmbartimor, debitori ka paraqitur prapësim me datën 28.12.2018, me të cilën pretendon se borxhi te cilin e kërkon kreditori është parashkruar sepse ka kaluar një vit nga koha kur i njëjti është bërë i kërkueshëm konform nenit 360 te LMD, shton se debitori nuk ka lidhur asnjëherë marrëveshje për Riprogramim, propozon qe gjykata ta pranoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj ndërsa ta detyroj kreditorin te paguaj shpenzimet procedurale.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datën 11.01.2019, me arsyetimin se debitori ka nënshkruar Kontratë për pagesën e borxhit dhe Deklaratën mbi Dakordimin e Borxhit, shton se debitori ka ndërprerë parashkrimin dhe atë konform nenit 368 te LMD sepse ka nënshkruar kontratat e lartcekura propozon qe gjykata ta lë ne fuqi urdhrin përmbartimor për caktimin e përmbartimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.533/2023 dt.31.10.2023, pas analizimit te kronologjisë se çështjes, vendimeve te Gjykatës se shkalles se parë dhe asaj te Apelit, ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Gjykata me tutje ne arsyetim te vendimit te saj potencon se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr.1 DMI 106229 ne bazë te cilës është lejuar urdhri përmbartimor i plotëson kushtet nga neni 29 dhe 37 te LPP, arsyeton se ekstrakti i verifikuar nga librat afariste nen shifrën DMI 106229 përmban te gjitha tiparet e dokumentit te besueshëm sipas nenit 29 par.3 te LPP. Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit se kërkesa e kreditorit është parashkruar ne kuptim te nenit 360 par.1 te LMD por gjeti se një pretendim i tille është i pabazuar sepse ne rastin konkret palë ndërgjygjese janë personat juridik . Gjykata citon edhe nenin 368 par.1 dhe 2 te LMD duke konstatuar se palët kane lidhur edhe Deklaratën mbi Dakordimin e Borxhit dhe kështu kanë shkaktuar ndërprerjen e afatit te parashkrimit, duke vlerësuar ne fund se nuk ekziston asnjë nga bazat ligjore nga neni 71 te LPP.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkalles se dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike qëndron ndryshe nga ajo e që ka vendosur në dispozitiv të aktvendimit të saj, ashtu që edhe e drejta materiale ndryshe duhet zbatuar, prandaj Gjykata e shkalles se dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kjo gjykatë vlerëson se debitori dhe kreditori kanë lidhur Kontratën për Pagesën e Borxhit nr.8659 dt.06.06.2016, konform Ligjit nr.05/L-043, Për Faljen e Borxheve Publike, i cili ligj në nenin 2 parasheh se *”Përfituesi duhet të përmbahet Programit, shumave dhe afateve të përcaktuara në Program. Ky program nuk mund të modifikohet“*, ndërsa neni 3 i Kontratës për Pagesën e Borxhit të lidhur me kreditorin, parasheh që *“Ne rastet kur përfituesi i shkakton tre vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e paguar e borxhit nëse ka fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”*. Deklarata Mbi Dakordimin e Borxhit nr.8659 dt.06.06.2016, e nënshkruar nga të dyja palët, parasheh dakordimin e palëve për pagesën e borxhit prej Janarit 2009 sipas Programit për Pagesën e Borxhit, dhe atë në 12 këste, ku 11 këste kanë vlerën prej 35 euro dhe një këst në vlerë prej 27.31 euro.

Nga ekstrakti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi del se debitori nga 12 këste të parapara dhe dakorduara me kreditorin për pagesë, i ka paguar nëntë këste. Gjykata e shkalles se dytë, bazuar në ekstraktin që shërben si dokument për ekzekutim në këtë rast, konstaton faktin se debitori nuk i është përmbajtur Kontratës për Pagesën e borxhit nr.8659 dt.06.06.2016, që brenda afateve të parapara në Deklaratë, të paguaj të gjitha këstet e dakorduara me kreditorin, sepse në lëndë nuk ka prova se janë paguar edhe tre këstet si detyrim i debitorit ndaj kreditorit, andaj në pajtim me nenin 3 të Kontratës nr.8659 dt.06.06.2016 e cila parasheh që *“Ne rastet kur përfituesi shkakton tri vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas Programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e mbetur e paguar e borxhit, nëse ka fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”*, rezulton se debitori mbetet në detyrime ndaj kreditorit në shumën si në propozimin për përmbartim.

Gjykata e shkallës se dytë analizon edhe pretendimin e debitorit se borxhi për të cilin pretendon kreditori është parashkruar por konsideron se ky pretendim nuk qëndron sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me subjekte juridike për të cilët vlen afati 3 vjeçar i parashkrimit dhe aplikohet dispozita e nenit 355 të LMD i cili në par.1 parasheh që *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite, ndërsa par.2 i këtij neni parasheh që “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*. Po ashtu neni 368 në par.1 parasheh që *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”* ndërsa në par.2 parasheh që *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*, andaj fakti se debitori ka paguar 9 (Nëntë) këstet sipas Ekstraktit *“pagesa e energjisë për KEK kësti 9 dt. 06.02.2017”* nga 12 të tillë sa ishin dakorduar me kreditorin rezulton se i njëjti e ka pranuar edhe detyrimin ndaj kreditorit si edhe me këtë ka ndërprerë edhe afatin e parashkrimit, ndërsa propozimi për parashkrim është bërë me dt. 19.12.2018. në baze të konstatimeve ete larte cekuar kuptohet se propozimi për përmbartim është bërë brenda periudhës 3 vjeçare, nga këto

konstatime te larte cekuar dëshmoheq qarte se borxhi i debitorit nuk ka arritur afatin e parashkrimit.

Andaj, këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles se Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore qe aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar dhe urdhri përmbarimit P.nr.1487/18 dt.19.12.2018, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa, për territorin e Gjykatës Themelore ne Mitrovicë te mbetët ne fuqi.

Gjykata e shkallës së dytë ka shqyrtuar pretendimin ankimor të kreditori për kompensimin e shpenzimet e procedurës por nuk e ka bërë specifikimin e tyre, andaj të njëjta i vlerëson si të pabazuar, pasi që kreditori nuk ka specifikuar shpenzimet, andaj në kuptim të nenit 463.1 të LPK-së, ka qenë dashur të specifikohen nga pala kreditore ashtu që të njëjtat ti kompensohen. Me nenin 463.1 të LPK-së është përcaktuar që *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbal lidhur me kërkesën. Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim...”*. Siç shihet, specifikimin e shpenzimeve veç e veç, përcaktimin e vlerave konform tarifës së aplikueshme dhe mbledhjen e tyre në një shumë totale, duhet ta bëjë pala që kërkon shpenzimet, dhe jo gjykata, gjë që pala kreditore nuk ka bërë një gjë të tillë. Në mungesë të specifikimit dhe konkretizimit të tyre, gjykata ka vendosur që secila palë të bartë shpenzimet e veta, duke vepruar kështu, konform nenit 463.1 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr.236/24, me datë 19.04.2024

Gjyqtari
Ramush Bardiqi